



## **Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit**

E mërkurë, 28 maj 2014

17:30 – 19:00

Ndërtesa kryesore e Qeverisë, kati i parë, salla P-38

### **KONKLuzionet e Përbashkëta**

#### **Pjesëmarrësit**

##### Kryesuesit:

Samuel Žbogar (Shef i Zyrës së BE-së /Përfaqësues Special i BE-së), Hajredin Kuçi (Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë), Bernd Borchardt (Shef i Misionit, EULEX)

##### Anëtarët dhe bashkëpunëtorët:

Gëzim Kasapolli (Zëvendësministër për Integritet Evropian); Saša Rasić (Zëvendësministër i Punëve të Brendshme); Thomas Muehlmann (shef i kabinetit, EULEX); Peter Bach (shef i sektorit për fuqizim, EULEX); Mats Mattsson (shef i sektorit ekzekutiv, EULEX).

##### Pjesëmarrësit e tjerë:

Enver Peci, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Nesrin Lushta, Gjykata Supreme e Kosovës; Shpend Maxhuni, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës; Hasan Preteni, Drejtor, Agjencia Kundër Korrupsionit; Sevdije Morina, zëvendës shefe e PSRK-së; Shemsi Hajrizi, drejtor në detyrë i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Arsim Gërxhaliu, drejtor i Departamentit të Mjekësisë Ligjore; Dafina Buçaj, CDF – këshilltare ligjore e ministrit të drejtësisë; Besnik Vasolli, këshilltar i ministres së integritetit evropian; Fisnik Rexhepi, këshilltar politik i ministrit të punëve të brendshme; Albert Avdiu, drejtor,



sekretaria e Këshillit Gjyqësor; Ehat Miftari, drejtor, Njësia për vlerësimin e përmbushjes së prokurorëve, KPK; Sylë Sefaj, këshilltar i ministrit të punëve të brendshme.

Andrew Powell, këshilltar ligjor /sundimi i ligjit, PSBE; Enrico Visentin, përgjegjës i detyrave për sundimin e ligjit, Zyra e BE-së; Stefano Gnocchi, këshilltar për çështje politike/komunitete, Zyra e BE-së; Merita Govori, përgjegjëse e detyrës/infrastrukturë, Zyra e BE-së; Behlul Zeka, këshilltar ligjor/sundimi i ligjit, PSBE; Gerrit-Marc Sprenger, kryetar në detyrë i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, EULEX; Jaroslava Novotna, kryeprokurore e EULEX-it, EULEX; Jonathan Ratel, Shef i PSRK-së, EULEX; Marjana Papa, asistente speciale e Shefit të Misionit, EULEX; Ismije Beshiri, udhëheqëse në detyrë e zyrës politike dhe të raportimit, EULEX; Vlora Marmullakaj, zyrtare e lartë kundër korrupsionit, EULEX; Alessandro Tedesco, udhëheqës i programit ZPKP, EULEX; Monique Kamies, këshilltare në Administratën Penale/Shërbimet Korrektuese, EULEX; Sonja Regler, udhëheqëse e programit ZPKP, EULEX.

## **1. Raporti i progresit i marrëveshjes kompakte: botimi i radhës**

BPSL u pajtua për publikimin e Raportit të Progresit të Marrëveshjes Kompakte 2014 në një konferencë për shtyp të caktuar për qershor 2014, në të cilën do të marrin pjesë tre kryesuesit e BPSL-së.

## **2. Ndryshimet Ligjore të AKP/KKPK: Sugjerimet**

BPSL vuri në dukje që Komisioni i Kuvendit për Legjislacion dhe çështje Gjyqësore ka aprovuar në parim projektligjin për Agjencinë Kosovare të Krahasimit dhe Verifikimit të Pronës (AKKVP). Megjithatë, për shkak të shpërbërjes së qeverisë, çështja ka mbetur e pazgjidhur deri në legjislaturën e ardhshme.

BPSL theksoi nevojën që qeveria t'i zgjidhë problemet e financimit për sekretarinë e AKP-së si çështje urgjente. BPSL po ashtu vuri në dukje qëllimin e Qeverisë së Kosovës që t'i rikthehet Kuvendit pas zgjedhjeve në mënyrë që draft legjislacioni përkatës të aprovohet sa më shpejtë që të jetë e mundur. Propozimet e EULEX-it për draft legjislacionin do të merren parasysh gjatë këtij procesi.



### **3. Treguesit (kriteret) kundër korrupsionit: gjendja aktuale**

BPSL analizoi përparimin e arritur në azhurnimin e matricës së aktiviteteve kundër korrupsionit. Është shënuar progres në veçanti lidhur me saktësinë e shifrave për rastet e korrupsionit dhe të rasteve të konfliktit të interesit në organet e prokurorisë dhe organet tjera kundër korrupsionit. KPK po ashtu u lavdërua për paraqitjen e hollësishme të të metave në sistemin e prokurorisë siç është mungesa e rregullores për organizimin e brendshëm të prokurorive, mos raportimin e akuzave penale nga ana e prokurorive dhe mos administrimi optimal i dosjeve. Megjithatë, BPSL vuri në pah fushat shqetësuese, siç është mungesa e angazhimit të shoqërisë civile dhe problemi i pazgjidhur i mospërputhshmërisë së të dhënave, gjë që vështirëson analizat krahasuese. BPSL inkurajoi aktorët përkatës të marrin masa të mëtejshme për adresimin e pengesave të përmendura në takim.

BPSL i dha për detyrë Grupit Punues (GP) që vazhdimisht t'i përcjellë zhvillimet gjatë muajve në vijim në mënyrë që ta përcjellë përparimin në plotësimin e treguesve (kriterëve); dhe të prezantojë një matricë të azhurnuar në takimin e ardhshëm.

### **4. Udhërrëfyeni për krimet e luftës: gjendja aktuale**

BPSL u informua lidhur me punën e GP që është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Udhërrëfyesit për Krime të Luftës dhe informoi për nevojën vendimtare për kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet prokurorëve vendas të PSRK-së dhe të Prokurorisë për Krime të Luftës të Beogradit.

BPSL kërkoi nga Grupi Punues ta çojë përpara punën lidhur me zbatimin e udhërrëfyesit dhe të raportojë në takimin e radhës.

### **5. Udhërrëfyeni për mbrojtjen e dëshmitarëve: gjendja aktuale**

BPSL u informua se Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në kuadër të PK-së është gati plotësisht e pajisur me të gjitha dokumentet e kornizës ligjore dhe marrëveshjet ekzistuese dhe tani është e gatshme për funksionim. Bëri të ditur se Drejtoria do të jetë e plotësuar në tërësi me personel deri në fund të vitit 2014.

BPSL kërkoi nga aktorët relevantë që ta çojnë përpara punën lidhur me zbatimin e udhërrëfyesit dhe të raportojnë në takimin e radhës.



## **6. Udhërrëfytesit për përcjelljen e të burgosurve në Mitrovicën veriore: gjendja aktuale**

BPSL i kushtoi vëmendje deklaratës së drejtorit në detyrë të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) lidhur me gatishmërinë e SHKK-së për marrjen e menjëhershme të përgjegjësive të përcjelljeve nga EULEX-i, në veri. Po ashtu, vërejti me shqetësim mungesën e personelit dhe të pajisjeve në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë dhe mirëpriti përkushtimin e përsëritur të autoriteteve vendase që janë të gatshëm për realizimin e të gjitha zotimeve të përvijuara në udhërrëfytes.

BPSL kërkoi nga aktorët relevantë që ta çojnë përpara punën lidhur me zbatimin e udhërrëfytesit dhe të raportojnë në takimin e radhës.

## **7. Udhërrëfytesit për Panelin e Ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronës: gjendja aktuale**

Kryesuesi i KGJK-së informoi BPSL-në që procesi i rekrutimit për një gjyqtar shtesë vendas për Panelin e dytë të Ankesave të AKP-së do të përfundojë brenda një muaji. BPSL po ashtu theksoi përkushtimin e Gjykatës Supreme për ta vazhduar listën e alternimit sipas së cilës gjyqtarët e Gjykatës Supreme që specializojnë në kontestet civile do të shërbejnë me radhë nga një muaj në Panelin e Ankesave. Megjithatë, u përmend që edhe elementet e tjera të udhërrëfytesit duhet të adresohen më tej për ta siguruar zbatimin e plotë.

BPSL ka kërkuar nga palët relevante me interes që të punojnë në implementimin e udhërrëfytesit dhe të raportojnë në takimin e radhës.

## **8. Udhërrëfytesit për Departamentin e Mjekësisë Ligjore: Gjendja aktuale**

BPSL u informuar nga drejtori i Departamentit për Mjekësi Ligjore (DML) mbi përpjekjet për transformimin e DML-së në një Agjenci, si dhe për dorëzimin e raportit fillestar për projektin e IPA-së për mbështetjen e DML-së (projekt prej 1.8 milion eurosh).

Përderisa DML-ja pret që të ketë trajnime dhe blerje të pajisjeve shtesë deri në muajin qershor, BPSL vlerëson se nevojitet një buxhet i mjaftueshëm për material shpenzues dhe mbështetje të vazhdueshme.



BPSL, kërkoi nga të gjitha palët e përfshira që të shqyrtojnë mundësinë e punës së mëtejme me qëllim të forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile, dhe që në mënyrë aktive të jenë në kontakt me familjet e personave të pagjetur.

BPSL-ja ka kërkuar nga palët relevante me interes që të punojnë në implementimin e udhërrëfyesit dhe të raportojnë në takimin e radhës.

### **9. Udhërrëfyesi për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme: Gjendja aktuale**

BPSL u informua nga Kryetari i KGJK-së se dy gjyqtarë shtesë do të emërohen brenda dy javëve të ardhshme. BPSL vërejti me shqetësim rritjen e numrit të rasteve të grumbulluara (aktualisht në pritje gjenden 16,126 raste) dhe rastet e mbetura për përkthim me rreth 3,500 faqe. BPSL kërkoi nga KGJK-ja dhe Gjykata Supreme që ta shqyrtojnë këtë çështje menjëherë, veçanërisht për mënyrën e rritjes së burimeve.

BPSL po ashtu, vërejti me shqetësim se procedurat vonohen për shkak të përgatitjes së dobët të paraqitjes së rasteve nga avokatët e klientëve dhe për faktin se ende nuk ekziston një faqe e internetit funksionale për DHPGJS. BPSL nënvizon rëndësinë e ligjit për kthimin e pasurisë. Grupi punues i Qeverisë së Kosovës i cili vitin e kaluar ka punuar në kategorizimin e pasurisë në Kosovë është duke i finalizuar definicionet për kategori dhe rekomandime.

BPSL ka kërkuar nga palët relevante me interes që të punojnë në implementimin e udhërrëfyesit dhe të raportojnë në takimin e radhës.

### **10. Implementimi i Kompaktit – Pavarësia e Gjyqësorit**

BPSL vërejti me keqardhje se masat konkrete që kontribuojnë në luftimin e ndërhyrjeve politike në fushën e sundimit të ligjit nuk ishin të gatshme për miratim.

BPSL e ngarkoi Sekretariatit që të formojë një grup punues, nëse është e nevojshme (me përfaqësim të KPK dhe KGJK), me qëllim të pajtimit për një varg masash konkrete dhe që pastaj ato të paraqiten para BPSL-së, më së largu deri në fund të korrikut.



## **11. Mekanizmi Përcjellës i Kompaktit: Gjendja aktuale**

BPSL miratoi versionin e azhurnuar të MPK që mbulon periudhën shtator 2013 – maj 2014. Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të dukshmërisë së përkushtimeve të BPSL-së drejt objektivave të sundimit të ligjit dhe për t'i mundësuar publikut të vlerësojë progresin dhe sfidat e mbetura, BPSL ftoi të gjitha institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë dhe agjencitë, ZBE dhe EULEX-in që në qershor në faqet e tyre të internetit të publikojnë MKP-në e azhurnuar dhe Raportin e Progresit nga Kompakti.

BPSL është pajtuar që Sekretariati i BPSL-së duhet të udhëheq – në kuadër të Kompaktit- konsultimet me të gjitha palët relevante dhe ato të propozuara, në bazë të Veprimeve aktuale të Kompaktit dhe duke reflektuar për progresin dhe prioritetet e reja, të rishikojë draftet e Veprimeve të Kompaktit, deri në fundi të korrikut.

BPSL rishikoi progresin në implementimin e Veprimeve të Kompaktit. Në këtë kontekst, Bordi njohu nevojën për dyfishimin e përpjekjeve për formimin e një Regjistri Civil të besueshëm, edhe në bazë të kopjeve të vërtetuara nga Serbia. Bordi e ka ngarkuar Agjencinë e Regjistrimit Civil që ta bëjë këtë punë në mënyrë të shpejtë.

Bordi po ashtu vërejti me shqetësim se institucione të ndryshme të sundimit të ligjit dhe faqet e internetit të qeverisë nuk po i përmbahen ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare. Bordi vlerëson përkushtimin e qeverisë për të adresuar këtë çështje deri në takimin e radhës.

## **12. Rishikimi i propozimit të ZBE/PSBE për çështjet ndëretnike të lidhura me pronat**

BPSL u informuar nga zëvendësministri për Integritet Evropian (MIE) për hapat që janë marrë për paraqitjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të shkallës së këtij problemi deri në fund të këtij viti. BPSL ftoi MIE që të raportojë për hollësitë e rezultateve të iniciativës në takimin e radhës.

## **13. Strategjia për Asistencë**

BPSL-së shkurtazi i ishte paraqitur Strategjia e Qeverisë për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit 2016-2019 në Kosovë, e hartuar sipas marrëveshjes gjatë takimit të fundit të Dialogut të Strukturuar për



Sundimin e Ligjit, i mbajtur më 16 janar 2014 në Bruksel, qëllimi i së cilit është të ndihmojë koordinimin e donatorëve në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme, i përgatitur nga institucionet vendëse dhe ndërkombëtare, dhe i miratuar nga qeveria.

#### **14. Pallati i Drejtësisë**

BPSL vlerësoi se Ministria e Drejtësisë, bashkë me Ministrinë e Administratës Publike (MAP) që është përgjegjëse për të gjitha çështjet administrative përfshirë ndarjen e zyrave në Pallatin e Drejtësisë, u përkushtua që institucionet e sundimit të ligjit do të barten në Pallatin e Drejtësisë deri në vjeshtë 2014.

BPSL nënvizoi se Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që e gjithë infrastruktura mbështetëse të jetë e vendosur me kohë për hapjen e Pallatit, duke përfshirë qasjen në Pallat dhe impiantin për trajtimin e ujërave shkarkuese. BPSL mirëpriti përkushtimin e Ministrisë së Drejtësisë për themelimin e një grupi punues bashkë me MAP-in, institucionet relevante të sundimit të ligjit, PSBE/ZBE dhe EULEX-in që të planifikojnë bartjen dhe të paraqesin udhërrëfyesin deri në fund të korrikut të vitit 2014.

